

# Lëvizjet e shtetasve në Shqipëri


## Janar, 2018

**Tiranë, më 23 Shkurt 2017:** Numri i shtetasve shqiptarë dhe të huaj të hyrë në vend, në muajin Janar 2018 është 605.444, duke u rritur 29,3 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Numri i shtetasve të huaj të hyrë në vend në muajin Janar 2018 është 232.338, krahasuar me Janar 2017, ky numër është rritur me 34,5 %.

Në Janar 2018, hyrjet nga Maqedonia kanë patur rritjen më të madhe me 47,2 %, në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Fig. 1 Lëvizjet e shtetasve në Shqipëri



Shtetasit shqiptarë dhe të huaj të dalë nga vendi, gjatë muajit Janar 2018, janë 726.463 duke shënuar një rritje me 30,2 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Numri i shtetasve shqiptarë të dalë nga territori i Shqipërisë, gjatë muajit Janar 2018, është 448.103. Krahasuar me Janar 2017, ky numër është rritur 20,8 %.

Hyrjet e shtetasve shqiptarë dhe të huaj në muajin Janar 2018, në rrugë tokësore zënë peshën më të madhe të hyrjeve gjithsej me 79,8 %, ndërsa hyrjet në rrugë ajrore zënë 16,6 % dhe detare zënë 3,6 %.

**Tab.1 Lëvizjet e shtetasve shqiptarë dhe të huaj**

Periudha	Janar 2017	Janar 2018	Ndryshimi vjetor (%)
<b>Hyrje gjithsej</b>	<b>468.162</b>	<b>605.444</b>	<b>29,3</b>
Shqiptarë	295.405	373.106	26,3
Të Huaj	172.757	232.338	34,5
<b>Dalje gjithsej</b>	<b>558.109</b>	<b>726.463</b>	<b>30,2</b>
Shqiptarë	371.041	448.103	20,8
Të Huaj	187.068	278.360	48,8

**Tab.2 Hyrjet e shtetasve të huaj sipas origjinës**

Shtetet	Janar 2017	Janar 2018	Ndryshim mujor (%)
Kosovë	57.482	77.221	34,3
Maqedoni	25.286	37.211	47,2
Greqi	23.504	30.916	31,5
Mali i zi	20.760	27.879	34,3
Itali	16.271	18.890	16,1
Angli	3.418	4.093	19,7
SHBA	3.052	3.555	16,5
Gjermani	2.506	2.715	8,3
Zvicër	1.601	1.650	3,1
Poloni	296	377	27,4
Të tjera	18.581	27.831	49,8
<b>Gjithsej</b>	<b>172.757</b>	<b>232.338</b>	<b>34,5</b>

**Tab. 3 Hyrjet e shtetasve të huaj sipas qëllimit**

Shtetet	Janar 2017	Janar 2018	Ndryshimi vjetor (%)
<b>Hyrje Shtetas të Huaj</b>	172.757	232.338	34,5
<b>I. Personale</b>	169.822	227.660	34,1
1. Pushime	17.617	41.307	134,5
2. Vizitë në miq e të afërm	526	821	56,1
3. Vizitë ditore	12.757	6.173	-51,6
4. Trajtim shëndetësor	43	22	-48,8
5. Qëllime fetare	26	41	57,7
6. Vizitorë të tjerë	130.245	169.106	29,8
7. Udhëtarë transit	8.608	10.190	18,4
<b>II. Biznes dhe profesionale</b>	2.935	4.678	59,4

**Tab. 4 Lëvizjet e shtetasve sipas mënyrës udhëtimit**

Periudha	Hyrje gjithsej			Dalje gjithsej		
	Ajër	Det	Tokë	Ajër	Det	Tokë
Janar 2017	90.437	22.421	355.304	102.900	55.129	400.080
Janar 20 18	100.598	21.974	482.872	113.819	46.884	565.760
Ndryshimi vjetor (%)	11,2	-2,0	35,9	10,6	-15,0	41,4

# Metodologji

## Përkufizime

**Vizitorë:** Për qëllime të statistikës së turizmit, termi “vizitor” nënkupton “një person që udhëton në një vend të ndryshëm nga vendi ku ai banon, për një periudhë më pak se 12 muaj dhe qëllimi kryesor i këtij udhëtimi në vendin e vizituar nuk është ai i një veprimtarie fitimprurëse”.

**Hyrjet:** Përfshijnë të gjitha hyrjet në kufi.

Hyrjet është një koncept që i referohet të gjitha arritjeve. Një person që viziton disa vende njëkohësisht gjatë një viti llogaritet çdo herë si një hyrje e re.

**Daljet :** Përfshijnë të gjitha daljet në kufi. Daljet masin fluksin e shtetasve që lënë vendin e referencës.

Qëllimi kryesor i vizitës është qëllimi pa të cilën udhëtimi nuk do të kryhej. Qëllimi i udhëtimit të vizitorëve dhe turistëve përfshin vizita për arsye:

Vizitat për *qëllime personale*

1. Pushime
2. Vizitë në miq e të afërm
3. Vizitë ditore
4. Trajtim shëndetësor
5. Qëllime fetare
6. Vizitorë të tjerë
7. Udhëtarë tranzit

*Kategoria e biznesit* përfshin të gjitha bizneset dhe aktivitetet profesionale jashtë ambjentit të zakonshëm.

**Burimi i të dhënave:** Të dhënat janë siguruar nga Ministria e Punëve të Brendshme (Drejtoria e Policisë së Shtetit).

Të dhënat e muajit të fundit janë paraprake dhe subjekt rishikimi. Për më shumë referohu: <http://www.instat.gov.al/al/rreth-nesh/cilesia-statistikore.aspx/> Politika e revizionimit statistikor.

Për t'u konsultuar me botime të tjera, vizitoni faqen e INSTAT: <http://www.instat.gov.al/>